



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 12446 / Prot.
18

Divjakë më 17 / 12 / 2025

THIRRJE
“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK DIVJAKË,
MUAJI DHJETOR, 2025 ”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijëni: **KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, **Ju njoftojmë se: Më datë: 29 . 12. 2025, ditën e Hënë , ora 10:00, tek Salla e mbledhjeve, kati i dytë, në Godinën e Bashkisë Divjakë, thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin **Dhjetor 2025**”. **Me këtë Rend dite:****

- 1.Miratim i Rendit të Ditës.
- 2.Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 26.11.2025.
- 3.Information mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Nëntor 2025.
4. **Projekt-vendim Nr. 83 datë.12.12.2025.** - Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga Fondi i kushtëzuar deri 6%, për muajin Nëntor 2025.
5. **Projekt-vendim Nr. 84 datë 12.12.2025** - Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor, 2025-2026.
6. **Projekt-vendim Nr. 85 datë 16.12.2025** - Për transferimin e disa funksioneve nga aparati i Bashkisë Divjakë, në shoqërinë e krijuar me VKB NR. 23 datë 24.04.2025 “ Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ Rrjela” sh.p.k dhe miratimin e Statutit dhe Aktit të themelimit”
- 7.**Projekt-vendim Nr. 86. datë 16.12.2025** - Për miratimin e përfundimit të proçedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK, pranë Drejtorisë Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
- 8.**Projekt-vendim Nr. 87 datë 16.12.2025** - Për miratimin e PBA 2026-2028, Buxhetit të vitit 2026, numrit të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjet vartëse të Bashkisë për vitin 2026.
- 9.**Projekt-vendim Nr. 88 datë 16.12.2025** - Mbi miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.
- 10.**Projekt-vendim Nr. 89 datë 16.12.2025** - Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, të Njësive Administrative dhe Funkcionet e deleguara , për vitin 2026.
- 11.**Projekt-vendim Nr. 90. datë 16.11.2025** – Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Divjakë, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2026.
12. **Projekt-vendim Nr.91 datë 17.12.2025** - Mbi miratimin e Planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Divjakë, për vitin 2026.

Njoftim: Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:

-Për pikat Nr: **4,6 ,7,8,9,10,11:**Komisioni i Ekonomisë dhe Financave.-Për pikën **Nr: 5**, Komisioni i Arsimit,Rinisë,Kulturës,Sporteve dhe Turizmit.

Duke ju falenderuar !

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Liri Biti

